



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16-19780/2012
Kaçanik, 31.07.2012

Në bazë të nenit 84 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008), në bazë të Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës: 22.05.2012, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 31.07.2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR MODIFIKIM TË VENDIMIT
01Nr. 16-8802/2012 të datës: 30.04.2012

I.

Me këtë Vendim, bëhet modifikimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 16-8802/12, i datës : 30.04.2012, që ka të bëjë me Riemërimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.

II.

Pika I. e Vendimit, 01Nr. 16-8802/12, i datës 30.04.2012, Modifikohet si në vijim:
Me këtë Vendim bëhet Riemërimi i pronës së paluajtshme komunale në të gjitha Institucionet ; Arsimore, Shëndetësore dhe të Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit, që në regjistrat kadastral janë evidentuar pasuri shoqërore e komunës, tani, Riemërohen si pronë e Paluajtshme e komunës Kaçanik.

III.

Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohet:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, (nëpërmjet kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante),
3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
4. Arkiva.

A R S Y E T I M

Kuvendi i komunës Kaçanik, me datë: 30.04.2012, ka marrë Vendimin 01Nr. 16-8802/2012 për riemërimin e pronës së paluajtshme komunale në të gjitha institucionet ;Arsimore, Shëndetësore dhe Bashkësive Vetëqeverisëse të Interesit.

MAPL, më datë: 22.05.2012, e ka shqyrtuar Vendimin e kuvendit të komunës, dhe ka kërkuar të bëjë modifikimin e Vendimit, ashtu që për pronat e komunës, regjistrimi i pronave të paluajtshme të komunave, të bëhet në pajtim me ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale nr. 03/L-226, dhe të gjitha pronat që janë të evidentuara në regjistrat kadastral të komunës, të konstatuara dhe verifikuara si pronë e komunës, të përdoret emërtimi i vetëm dhe unik, “pronë e paluajtshme e komunës”.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi
